



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1572/5 prot.

Tiranë më 06.09.2024

REKOMANDIM

Nr. 09, datë 06.09.2024

PËR KONTROLLUESIN “KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji nr.9887/2008”), ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), në ngarkim të kontrolluesit “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ka marrë në shqyrtim ankesën nr. 1572 Prot., datë 21.06.2024 të znj. (në vijim, “Ankuesja”), me objekt:

- *Vënien në dispozicion të Rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit që ka të bëjë me procedurën e hedhjes së shortit të datës 16.12.2019, kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, lidhur me kontrollin e subjekteve të rivlerësimit, listë në të cilën është përfshirë dhe vetë ankuesja.*
- 1. Nga shqyrtimi i provave të administruara bashkëlidhur ankesës, konkretisht shkresa kthim përgjigje nr. 1494/1, datë 04.06.2024 e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit drejtuar ankueses, Kontrolluesi është shprehur se informacioni i kërkuar është konfidencial dhe se dhënia e këtij informacioni përbën një të drejtë të kufizuar.

Këto pretendime janë bazuar në pikën 7, të nenin 4, të ligjit nr. 84/2016 në të cilin parashikohet se “E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit”.

Gjithashtu pretendimet e Kontrolluesit në shkresën e sipërcituar bazohen edhe në nenin 31 të rregullores për veprimtarinë e KPK-së në cilin parashikohet se *“E drejta e informimit garantohet sipas parashikimeve të ligjit “Mbi të drejtën e informimit” dhe mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 7, të ligjit nr. 84/2016”*.

2. Komisioneri në kuadër të zgjidhjes së ankesës, me shkresën nr. 1572/1 Prot., datë 10.07.2024 ka kërkuar nga Kontrolluesi informacion dhe sqarime në lidhje me pretendimet e ankueses, si dhe ka bërë me dije detyrimet që burojnë nga dispozitat e Ligjit nr. 9887/2008”.
3. Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, me shkresën nr.1730/2, datë 31.07.2024 administruar me tonën nr. 1572/3 prot., datë 02.08.2024, Kontrolluesi ka sqaruar se, Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit është dokument i konsideruar konfidencial dhe është bërë objekt i Mbledhjes së Komisionit duke cituar si bazë ligjore pikën 8 të nenit 3 të *“Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në KPK”* i cili parashikon se: *“Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kryen procedurat për organizimin e një shorti të veçantë dhe të posacëm, pas rekomandimit me shkrim të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi.”*

Në këtë shkresë Kontrolluesi është mbështetur në nenin B të Aneksit të Kushtetutës, ku sanksionohen roli, misioni dhe detyrat e ONM-së, si dhe në pikën 7, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 në të cilin parashikohet se *“E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit”*.

Gjithashtu, Kontrolluesi citon edhe nenin 31, pika 2 e Rregullores për veprimtarinë e KPK-së në të cilin parashikohet se *“Raporti i relatorit, projektvendimi, çfarëdo informacioni për diskutimin dhe për votimin e trupës, projektvendimet dhe çfarëdo shënimesh të anëtarëve të trupës gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit të rastit, mendimet e 19 këshilltarëve si dhe materiali tjetër i përcaktuar nga mbledhja e komisionit duhet të jenë konfidencialë dhe në të nuk do të kenë akses as palët e as publiku”*. Si dhe germën ë), pika 2 e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* e cila parashikon se: *“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërko-mbëtare ose ndërqeveritare.”*

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, nuk rezulton në asnjë paragraf të jetë përcaktuar kufizim në lidhje me rekomandimet e ONM-së dhe vënien në dispozicion të tyre subjekteve të përfshirë në rivlerësim. Dispozitat e cituara nga Kontrolluesi nuk përputhen me objektin e ankesës dhe nuk paraqesin asnjë kufizim për rastin konkret.

4. Pas verifikimit të bazës ligjore dhe fakteve të evidentuara nga korrespondenca shkresore me Kontrolluesin, Komisioneri vlerëson se, në përmbajtje të procedurës të hedhjes së shortit të datës 16.12.2019 kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ka të dhëna personale të ankueses, të cilat rregullohen nga Ligji nr. 9887/2008. Kështu në pikën 1, të nenit 3 të Ligjit nr. 9887/2008, parashikohet se: *“Të dhëna personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social”*.

Në nenin 12 të Ligjit nr. 9887/2008 parashikohet e drejta e aksesit, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit të marrë informacion nga kontrolluesi, lidhur me përpunimin e të dhënave të tij dhe në të njëjtën kohë nënkupton vendosjen në dispozicion të dokumenteve me të dhëna personale të subjektit brenda afatit ligjor të parashikuar, nëse nuk ka kufizime ligjore për rastin.

E drejta e aksesit parashikohet edhe në **pikën 2, të nenit 28 të ligjit nr. 84/2016** *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, ku citohet shprehimisht: *“Anëtari i institucionit të rivlersimit dhe personeli i tyre trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Institucionet e rivlerësimit përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit ose organeve që me ligj kanë të drejtë t’u kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare”*.

Komisioneri vlerëson se, argumentet e paraqitura nga Kontrolluesi, për refuzimin e aksesit në rastin konkret nuk mbështeten në kritere apo dispozita ligjore. Për më tepër parashikimet e rregullores (si një akt i brendshëm) nuk mund të jenë në kundërshtim apo të prevalojnë mbi një të drejtë ligjore, që buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që ka parashikime të posaçme edhe në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, që lidhen drejtpërdrejtë me të drejtat e subjektit të të dhënave personale referuar të drejtës për akses të parashikuar në nenin 12 të Ligjit nr. 9887/2008.

Kufizimet rrjedhimisht të së drejtës për akses në të dhënat personale, janë të pranueshme nëse janë të parashikuara në ligj dhe nëse duke argumentuar, cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomike dhe financiare të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale (Pika 3 e nenit 12, e Ligjit nr. 9887/2008).

Në rastin objekt ankimi në asnjë moment Kontrolluesi nuk ka provuar rrethana të tilla. Refuzimi i aksesit në të dhënat personale mund të dëmtojë vetë thelbin e kësaj të drejte themelore për t’u ushtruar atë, por edhe të të drejtave të tjera themelore, të cilat i përkasin çdo individ.

Kontrolluesi nuk mund të ndërhyjë në mënyrë jo proporcionale, duke cënuar për pasojë të drejtën e subjektit të të dhënave personale për një proces të rregullt ligjor të garantuar nga Kushtetuta. E drejta e palës në një proces gjykimi për t’u njohur me të gjithë dokumentacionin dhe faktet që administrohen në proces rreth saj është parakusht i një

procesi të rregullt ligjor, si një ndër parimet thelbësore të njohura nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke i dhënë mundësi palës të mbrohet efektivisht dhe të ushtrrojë të drejtat të njohura nga këto akte.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit, si dhe angazhimin e tij për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, në formën në të cilën përpunohet/ruhet prej tij (pavarësisht faktit nëse subjekti i të dhënave mund të disponojë këtë informacion në një formë tjetër).

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6,12, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit nr. 9887/2008.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi të marrë masa për garantimin e të drejtës së subjektit të të dhënave në përputhje me nenin 12, të Ligjit nr. 9887/2008.
2. Kontrolluesi të vendosë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, në formën në të cilën përpunohet/ruhet prej tij dhe të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
3. Në rast mospërbushjeje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit nr.9887/2008, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të këtij ligji nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më datë 06.09.2024

KOMISIONERI

Besnik Dervishi